



Fletë Informacioni për Pjesëmarrësit

Projekt Kërkimor: Promovimi dhe Ndërhyrja e Shëndetit Mendor në Vendin e Punës

Ju ftojmë të merrni pjesë në një studim kërkimor të një ndërhyrjeje që synon përmirësimin dhe promovimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies në vendin e punës, si dhe të luftojë kundër stigmës ndaj shëndetit mendor. Para se të vendosni nëse dëshironi të merrni pjesë, është e rëndësishme për ju të dini pse po bëhet kërkimi dhe çfarë do të përfshinte pjesëmarrja juaj. Ju lutemi, merrni kohë për të lexuar me kujdes informacionin e mëposhtëm. Ndihuni të lirë të n'a pyesni nëse keni ndonjë gjë të paqartë ose nëse dëshironi më shumë informacion.

Çfarë përfshin ky projekt?

Depresioni dhe ankthi janë problemet më të përhapura të shëndetit mendor në vendin e punës në BE, duke shkaktuar vuajtje shumë të mëdha dhe duke i kushtuar ekonomisë globale 1 trilion euro çdo vit në produktivitet të humbur. Veçanërisht, ato që punojnë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) janë më vulnerabël. Sidoqoftë, shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) kanë kapacitete të kufizuara për të adresuar promovimin e shëndetit mendor dhe për të ofruar ndërhyrje të shëndetit mendor për stafin e tyre. Projekti synon të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien mendore, si dhe të reduktojë depresionin dhe idetë vetëvrasëse te punonjësit dhe punëdhënësit e NVM-ve në Evropë dhe Australi.

Cili është qëllimi i këtij studimi?

Ky studim synon të shqyrtojë efektivitetin e ndërhyrjes në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në nëntë vende partnere. Studimi do të ndihmojë në marrjen e informacionit mbi standardin dhe intensitetin e kryerjes së ndërhyrjes, si dhe informacion mbi perspektivat dhe përvojat e punonjësve dhe punëdhënësve që u përfshinë në ndërhyrje. Ky studim do të përfshijë punonjësit dhe punëdhënësit e NVM-ve në sektorët e shëndetësisë, ndërtimit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), pasi këta sektorë janë identifikuar si më të ndjeshëm dhe me rrezik në rritje të vështirësive të shëndetit mendor. Megjithatë, qëllimi përfundimtar i projektit është zgjerimi i programit për të gjitha NVM-të. Duke marrë parasysh ndikimet afatgjata të njerëzimit në përgjithësi, veçanërisht të njerëzimit me probleme ekzistuese të shëndetit mendor, si rezultat i pandemisë COVID-19, ky projekt është jashtëzakonisht në kohë.

Çfarë do të thotë për mua pjesëmarrja në projekt?

Ky projekt ka marrë financim nga programi i kërkimit dhe inovacionit Horizon 2020 i Bashkimit Evropian sipas marrëveshjes së grantit nr. 848137. Materiali i paraqitur dhe pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Komisioni i BE-së nuk merr përgjegjësi për çdo përdorim të informacionit të përcaktuar.



Ky studim përfshin kryerjen e një prove klinike të rastësishme ku ata që përfundojnë ndërhyrjen krahasohen me një grup që nuk e përfundojnë ndërhyrjen. Do të zhvillohet një seancë e shkurtër prezantuese, e organizuar nga hetuesi kryesor dhe oficeri i kërkimit në vendin tuaj, për t'ju treguar rreth studimit, për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni dhe për t'ju treguar se si të regjistroheni për të marrë pjesë në studim. Pasi të regjistroheni për të marrë pjesë, ju dhe organizata juaj do të caktoheni në një nga dy grupet: (1) grupi i ndërhyrjes të cilit do t'i ofrohet një ndërhyrje në internet, e bazuar në prova për shëndetin mendor ose (2) grupi i listës së pritjes të cilit do t'i ofrohet ndërhyrje online pas një periudhe trembëdhjetë mujore në listën e pritjes. Të gjithë pjesëmarrësit përfundimisht do të kenë akses në ndërhyrjen online.

Përpara se të fitoni akses në ndërhyrje (ose të filloni periudhën e pritjes), do t'ju kërkohet të plotësoni një anketë. Ky sondazh do të vlerësojë mirëqenien, burnout-in, simptomat depresive dhe idetë vetëvrasëse dhe do të ndihmojë në sjelljen e kërkimit të vetë-ndihmës. Gjithashtu do t'ju kërkohet të plotësoni një fletë standarde socio-demografike, e cila do t'ju bëjë pyetje të tilla si gjinia, mosha dhe statusi martesor. Do të mblidhen gjithashtu informacione të rëndësishme në lidhje me punën, marrëdhënien, familjen, shëndetin dhe shëndetin tuaj mendor. Ky sondazh do të marrë afërsisht 30 minuta nga koha juaj. Do t'ju kërkohet të plotësoni anketat edhe në dy raste të tjera: nëntë muaj dhe trembëdhjetë muaj pas sondazhit të parë. Plotësimi i sondazheve në këto momente kohore do të na ndihmojë të identifikojmë çdo ndryshim që keni përjetuar gjatë periudhës së kësaj ndërhyrjeje.

Si do të përfitoj nga pjesëmarrja në këtë hulumtim?

Ndërhyrjet që ofrohen janë të bazuara në prova, dhe për këtë arsye pritet të jenë të dobishme për individët me ose pa një problem klinikisht të rëndësishëm të shëndetit mendor. Bazuar në përdorimin e ndërhyrjeve të bazuara në prova, parashikohet që përfitimet e përjetuara nga pjesëmarrësit mund të përfshijnë një reduktim të stresit, burnout-it, simptomave të depresionit dhe ankthit, si dhe reduktimin e mundshëm të stigmës lidhur me shëndetin mendor (të sëmurë). Studimi pritet të përmirësojë shëndetin tuaj të përgjithshëm mendor, i cili nga ana tjetër do të ketë rëndësi në mirëqenien tuaj të përgjithshme dhe performancën e punës.

Në projektet e mëparshme, ndërhyrjet e ofruara në këtë studim janë treguar të kenë efekte të dobishme në shëndetin mendor pa asnjë efekt negativ. Prandaj, nuk parashikohet që të ketë ndonjë efekt negativ për pjesëmarrësit.

Duke marrë parasysh ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata të COVID-19, duke përfshirë stresin dhe ankthin e stafit, cilësinë e reduktuar dhe ndoshta intensitetin e kujdesit për ata me çrregullime mendore, ose ndikime të tjera që lidhen me krizën COVID-19, projekti është në kohën dhe momentin e duhur për t'ju ofruar NVM-ve mbështetje dhe mjete ndërhyrjeje me fokus të veçantë në zbutjen e depresionit dhe ankthit tek stafi.

Si do të përdoret informacioni im?

Ky projekt ka marrë financim nga programi i kërkimit dhe inovacionit Horizon 2020 i Bashkimit Evropian sipas marrëveshjes së grantit nr. 848137. Materiali i paraqitur dhe pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Komisioni i BE-së nuk merr përgjegjësi për çdo përdorim të informacionit të përcaktuar.



Informacioni që jepni do të përdoret për të kuptuar shëndetin dhe mirëqenien mendore, për të identifikuar faktorët që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien mendore dhe do të përdoret për të vlerësuar përfitimet e ndërhyrjeve.

Gjetjet nga studimi pilot do të publikohen në revista akademike dhe burime të tjera si media sociale dhe buletinet e lajmeve. Gjetjet do të raportohen për të gjitha të dhënat e mbledhura, jo për të dhënat individuale, dhe ata që përfundojnë analizën e të dhënave nuk do të kenë akses në emrat e pjesëmarrësve duke siguruar anonimitetin e pjesëmarrësve në asnjë publikim.

A do të mbahet konfidenciale pjesëmarrja ime në këtë projekt?

Nëse është e mundur ta realizoni këtë projekt ballë për ballë, ekipi kryesor i projektit do t'ju takojë dhe do ta dijë se jeni duke marrë pjesë. Për më tepër, elementët e ndërhyrjeve mund të ndodhin brenda mjedisit të vendit tuaj të punës, si p.sh. një sesion prezantimi dhe seminare. Çdo informacion që jepni do të përdoret vetëm për qëllimet e këtij projekti. Nëse dëshironi të aksesoni informacionin tuaj ose nëse dëshironi që informacioni juaj të fshihet në çdo kohë, mund të kontaktoni ekipin e kërkimit në detajet e kontaktit më poshtë. Më shumë informacion në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e informacionit tuaj personal është i detajuar në Njoftimin për Mbrojtjen e të Dhënave më poshtë.

Pjesëmarrja juaj

Pjesëmarrja është vullnetare dhe ju mund të zgjidhni të mos merrni pjesë pa dhënë një arsye dhe pa përjetuar ndonjë pasojë negative. Vendimi për t'u tërhequr nga projekti në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë në jetën tuaj të punës dhe është e mundur të tërhiqeni duke njoftuar Oficerin e Kërkimit Shkencor (detajet e së cilit janë paraqitur më poshtë).

Kush e organizon dhe financon këtë projekt?

Projekti po kryhet nga një konsorcium ndërdisiplinor i udhëhequr nga profesoresha Ella Arensman, Shkencëtare kryesore, Fondacioni Kombëtar i Kërkimit të Vetëvrasjeve (NSRF), Irlandë. Studimi do të drejtohet nga Profesoresha Ella Arensman, Investiguese kryesore, dhe Dr. Paul Corcoran, Drejtues i Kërkimeve në Fondacionin Kombëtar të Kërkimit të Vetëvrasjeve (NSRF). Projekti financohet nga Komisioni Evropian, Horizon 2020.

Informacion shtese

E kuptoj që nëse kam ndonjë pyetje në lidhje me këtë hulumtim, mund të kontaktoj Investiguesin Kryesor të studimit (detajet e së cilit janë paraqitur më poshtë). Unë e kuptoj që studimi është miratuar nga KOMITETI I ETIKËS dhe nëse kam pyetje të mëtejshme në lidhje me të drejtat e mia në lidhje me kërkimin, mund të kontaktoj:

- Prof. Gentiana Qirjako, Koordinatorë e studimit për Shqipërinë



Adresa: Qendra e Shëndetit dhe Mirëqënies Komunitare, Tiranë, Shqipëri

tel: (+355) 674027657

email: gentaqirjako@gmail.com

Për më shumë informacione gjatë projektit është në dispozicion:

Msc. Arilda Dushaj, Specialiste/Oficere Kërkimi Shkencor, Projekti MENTUPP

Adresa: Qendra e Shëndetit dhe Mirëqënies Komunitare, Tiranë, Shqipëri

tel: (+355) 699197591

email: arildadushaj@hotmail.com

Facebook: Community Centre for Health and Wellbeing